Kontraktuesi duhet të sigurojë, për aq sa është e praktikueshme në mënyrë të arsyeshme si dhe me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, shëndetin, sigurinë, dhe mirëqenien në punë për të gjithë punonjësit e tij duke përfshirë këtu edhe ata që janë të nënkontraktuar dhe të gjitha personat e tjerë që ndodhen në Sheshin e Punimeve. Përgjegjësitet e tij do të përfshijnë:

- (a) furnizimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit të Ndërtimit në mënyrë që sistemi i punës të jetë i ndriçuar, i sigurt dhe pa rreziqe për shëndetin;



- (b) kryerjen e rregullimeve të përshtatshme për të garantuar sigurinë dhe mungesën e rreziqeve për shëndetin në lidhje me përdorimin, rregullimin, ruajtjen, transportin dhe disponueshmërinë e artikujve dhe substancave;
- (c) furnizimi me rroba dhe pajisje mbrojtëse, vende të ndihmës së shpejtë me personel dhe pajisjet e nevojshme si dhe me informacionin, instruksionin, trajnimin dhe mbikqyrjen e nevojshme për të siguruar shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës për të gjithë personat e punësuar për këto Punime në përputhje me Ligjet në fuqi;
- (d) caktimin e një personi të stafit si Oficer Sigurie i cili duhet të ketë njohje specifike mbi rregulloret për sigurinë si dhe eksperiencë në marrjen e masave të sigurisë për punë të ngjashme dhe i cili do të japë këshilla për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e punonjësve dhe për masat që duhet të merren për të promovuar këtë siguri;
- (e) sigurimin dhe mirëmbajtjen e të drejtës së hyrjes në të gjitha vendet e Sheshit të Punimeve në kushte të sigurta dhe pa rrezik dëmtimi;
- (f) furnizimin me ujë në kushte sanitare të përshtatshme, heqjen e mbeturinave dhe mbetjeve, në përputhje me të gjitha ligjet kombëtare dhe lokale në fuqi dhe në përputhje me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, për të gjitha shtëpitë, zyrat, vendet e punës, si dhe labororet e ngritura në sheshin e ndërtimit ose në sheshet e tjera;
- (g) furnizimi me një numër të mjaftueshëm tualetesh dhe kushte të tjera sanitare në vendet ku puna është në proces dhe ekzekutimi i masave të përshtatshme në këshillim me Autoritetin e Shëndetit Publik për të kontrolluar vendin për mushkonja, miza dhe insekte të tjera duke përfshirë këtu edhe aplikimin e kimikateve të duhura për zonat me probleme;
- (h) raportimi tek Menaxheri i Projektit detajeve për çdo incident si dhe Policisë nëse konsiderohet si e përshtatshme sa më parë pasi ka ndodhur.

1.9 Mbledhjet mbi sigurinë e Sheshit të Ndërtimit

Të paktën njëherë në muaj gjatë kryerjes së Punimeve, në një datë të caktuar nga Menaxheri i Projektit, do të mbahet një mbledhje mbi sigurinë e sheshit të ndërtimit. Do të marrë pjesë Menaxheri i Projektit, Përfaqësuesi i Kontraktuesit, Oficeri i Sigurisë i caktuar nga Kontraktuesi si dhe nga anëtarë të tjerë të stafit të tyre që mund t'i kërkojë Menaxheri i Projektit.

Do të mbahet procesverbal i mbledhjes dhe çdo veprim i kërkuar për t'u ndërmarrë do të shënohet me kujdes dhe të shënohet për ndërmarrje veprimi nga palë të caktuara.

Në mbledhje do të diskutohet:

- Veprimet e ndërmarra në përputhje me shënimet në procesverbal të mbledhjes për sigurinë e sheshit të ndërtimit të muajit të kaluar
- Ngjarjet që kanë patur problem që prej mbledhjes për sigurinë e sheshit të ndërtimit
- Ngjarjet e paraprirë të muajit të ardhshëm që mund të kenë përbërë ndonjë problem.

Eshtë qëllimi i mbledhjes për sigurinë e sheshit të ndërtimit që të identifikojë dhe adresojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e sheshit dhe të garantojë që këto çështje dhe masat që do të merren për këto të fundit qëndrojnë prioritet i vëmendjes së stafit.

1.10 Njoftimet për Aksidentet

Kontraktuesi do të njoftojë menjëherë Menaxhern e Projektit në rastet kur ndodhin aksidentet (në shesh ose jashtë sheshit) në të cilin Kontraktuesi, personeli i tij, ose Impianti i Ndërtimit apo ato të nënkontraktuesëve të tij janë të përfshirë direkt ose indirekt në dëmtimet ndaj këtyre njerëzve. Një njoftim i tillë mund të jetë verbal në fillim, por duhet të ndiqet nga një raport gjithëpërfshirës brenda 24 orëve që ka ndodhur incidenti.

1.11 Siguria në Rrugë dhe Kontrolli i Trafikut

Kontraktuesi nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim në rrugë publike apo në afërsi të tyre pa njoftuar në fillim Menaxherin e Projektit dhe pa marrë miratimin e tij më pas për të vepruar. Për të marrë miratim ai duhet të deklarojë qartë detajet e shenjave dhe masave për kontrollin e trafikut që propozon të përdorë si dhe datat dhe oraret gjatë të cilave do të punojë në rrugë publike apo afër tyre. Gjatë punimeve të tij ai duhet të sigurojë se rruga publike do të mbetet e hapur dhe e gatshme për përdorim si dhe në gjendje të mirë dhe se vonesat në trafik do të minimizohen.

1. Kërkesa të Përgjithshme

Kontraktuesi duhet t'i mbajë rrugët ekzistuese të hapura ndaj trafikut gjatë punimeve të ndërtimit por mund ta kalojë trafikun në një rrugë anësore me standarde të barabarta kur kjo e fundit të jetë miratuar nga Menaxheri i Projektit. Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për të kostot e të gjitha shmangieve në rrugë.

Kontraktuesi duhet t'i mbajë rrugët që do të preken nga punimet të pastra nga dherat dhe materialet e tjera të mbetura si dhe të sigurojë që zona e ndërtimit mund të akomodojë trafikun me siguri në çdo kohë. Kontraktuesi do të ngrejë dhe mbajë shenja, barrikada, dhe të tjera mjete për kontrollin e trafikut siç mund të kërkohen për të drejtuar trafikun brenda dhe jashtë zonave të ndërtimit dhe siç indikohet nga Manuali mbi Mjetet Uniforme për Kontrollin e Trafikut, Pjesa 6 – Kontrolli i Trafikut të Përkohshëm ose siç drejtohet nga Menaxheri i Projektit. Kontraktuesi, pa kompensime shtesë, do të zëvendësojë mjetet e kontrollit të trafikut që mund të humbasin, që mund të jenë vjedhur, shkatërruar apo konsideruar si të papranueshme kur është kërkuar përdorimi i tyre.

Gjatë orëve të pushimit dhe me përfundimin e punimeve të një ndërtimi, të gjitha shenjat e paralajmërimit, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për sigurinë e publikut, do të hiqen. Sipërfaqet e lyera dhe retro-pasqyruese tek shenjat, barrikadat dhe të tjera mjete do të mbahen të pastra, në gjendje të mirë pune, si dhe të kenë gjithmonë aftësinë e tyre retro-pasqyruese. Masat, ngjyrat, mesazhet dhe vendndodhjet do të jenë me miratimin e Menaxherit të Projektit.

Kontraktuesi do të kujdeset gjatë gjithë kohës për të siguruar përshtatshmërinë dhe sigurinë e banorëve përgjatë rrugës apo ndonjë autostrade publike të prekur nga Punimet. E drejta e hyrjes në afërsi të vendit të Punimeve do të mbahet gjithmonë.

Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për hetimin dhe vendosjen e kërkesave për kontrollin dhe sigurinë e trafikut. Kjo përfshin familjarizimin me kushtet e trafikut, rëndësinë e mbajtjes së sigurisë të trafikut dhe minimizimin e vonesave në trafik duke bashkëpunuar me agjencitë përkatëse për kontrollin e trafikut.

2. Masat për Kontrollin e Trafikut

Për të lehtësuar lëvizjen e trafikut dhe sigurinë në vendet e punimeve që janë afër, Kontraktuesi do të furnizojë dhe do mirëmbajë shenjat e trafikut, dritat, barrikatat, konet dhe materiale të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga Menaxheri i Projektit.

Për kontrollin e duhur të trafikut siç nevojitet apo kërkohet ose drejtohet nga Menaxheri i Projektit, Kontraktuesi do të furnizojë dhe të vendosë persona me flamura detyra e të cilëve do të jetë të drejtë lëvizjen e trafikut përmes ose anash punimeve. Me qëllim minimizimin e ndërprerjes së trafikut, Kontraktuesi mund t'i mbyllë me gardh përkohësisht pjesë të Sheshit, siç nevojitet për të siguruar një barrierë vizive midis zonës së punimeve dhe trafikut të afërt

Mjetet për kontrollin e trafikut do të jenë në përputhje me standardet e Amerikës së Veriut, veçanërisht ato të cituara në botimin aktual të Manualit të Mjeteve uniforme të Kontrollit të Trafikut, Pjesa 6 – Kontroll i Përkohshëm i Trafikut si dhe kërkesat e mëposhtme:

- Panelet e shenjave do të jenë ngjyrë portokalli me legjendë të zezë me përjashtim të rastit kur specifikohet ndryshe.
- Postbolloqet do të kenë dru të butë ose material tjetër të pranueshëm nga Menaxheri i Projektit.
- Shenjat duhet të jenë në gjendje të qëndrojnë në pozicionin e tyre gjatë trafikut normal dhe kushteve me erë.
- Barrikatat dhe gardhet e përkohshme do të ndërtohen prej druri, metali ose plastike dhe të jenë të lyera me drejtim nga trafiku.
- Konet do të kenë një lartësi minimumi 75 cm me një bazë të zgjeruar dhe të jenë në gjendje që të përballojnë impaktet pa dëmtime të koneve apo automjeteve. Të gjitha konet do të kenë ngjyrë portokalli/të bardhë, të jenë të dallueshme dhe të jenë në gjendje të qëndrojnë në pozicionin e tyre në kushtet e trafikut normal dhe me erë.
- Dritat e paralajmërimit (elektrike, me ngjyrë, flash, nga të dyja anët) do të jenë ashtu siç do të miratohen nga Menaxheri i Projektit
 - Mjetet e kontrollit të trafikut do të përdoren vetëm kur të jenë nevojta.

3. Numri i rrugëve të trafikut

Kontraktuesit i kërkohet të mbajë një sipërfaqe me standard të barabartë me atë të rrugës origjinale gjatë gjithë kohës, për sa i përket gjerësisë, kurbave, gradientit, dhe cilësisë së dhënies së makinës dhe të bëjë punimet e duhura për të arritur këtë. Menaxheri i Projektit mund të miratojë një rrugë të përkohshme me shenja të sakta për shmangien e trafikut atëherë kur Kontraktuesi mund të vërtetojë se kjo nuk do të shkaktojë vonesa të panevojshme në qarkullimin e trafikut. Me një miratim të tillë, Menaxheri i Projektit mund të përcaktojë oraret kur mund të përdoret rruga me kapacitet të reduktuar. Nëse ndodhin vonesa shtesë, Menaxheri i Projektit mund ta tërheqë miratimin e tij dhe në raste të tilla, Kontraktuesit i kërkohet që të rivendosë standardet e rrugës origjinale brenda 48 orëve.

Kur me mendimin e Menaxheri i Projektit, shmangia nuk është e arritshme, ndërtimi në rrugët publike ekzistuese do të bëhet vetëm në gjysëm e gjerësisë së plotë të rrugës. Gjatësia e një rruge me mbylljen e njëjës gjysmë do të minimizohet dhe gjerësia e korsisë së përdorshme do të jetë jo më pak se 3.0m.

2. KONTROLLI I CILESISE

2.1 Pershkrimi

Kjo pjesë përshkruan kërkesat për mirëmbajtjen e cilësisë përgjatë kësaj Kontrate. Kontraktuesi mban përgjegjësi për cilësinë e kontrollit të ndërtimeve, materialeve, prodhimet dhe instalimet që përfshijnë Punimet. Kontraktuesi duhet të vendosë dhe mbajë një sistem kontrolli cilësie efikas. Sistemi duhet të jetë i përshtatshëm në mënyrë që të mbulojë të gjitha veprimet dhe do të jetë celsi i Deklaratave të Metodave të Aprovuara.

Sistemi do të konsistojë në plane, procedura dhe stafi i duhur për të kontrolluar cilësinë e të gjitha materialeve dhe produkteve të përfunduara të cilat përbëjnë Punimet në përputhje më të gjitha kërkesat e Kontratës. Sistemi do t'i përfshijë të gjitha veprimet, përfshirë këtu produktet ose fabrikimet në shesh dhe jashtë sheshit, mbledhjen e materialit mostër, testimi, inspektimi dhe menaxhimi i kontrollit për të siguruar që Puna është konform me Dokumentat e Kontratës.

2.2 Organizata e Kontrollit të Cilësisë së Kontraktuesëve

1. Menaxheri i Kontrollit të Cilësisë. (KC)

Kontraktuesi do të caktojë një person brenda organizatës së tij që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të veprimeve KC dhe i cili do të ketë autoritetin të veprjë në të gjitha çështjet KC në emër të Kontraktuesit. Menaxheri KC do të jetë në Inxhinier i kualifikuar me një minimum prej 10 vjetësh projektsh ose eksperiencë pune të ngjashme. Menaxheri KC do të jetë në Shesh gjatë gjithë kohës së Punimeve dhe do të punësohet nga Kontraktuesi dhe miratohet nga Menaxheri i Projektit.

Menaxheri KC do të raportojë direkt tek një ekzekutiv i Organizatës së Kontraktuesit dhe do të jetë autoritet dhe Status ekuivalent me Menaxheri i Projektit të Kontraktuesit. Ai do të ketë përgjegjësinë dhe autoritetin të mbulojë Menaxherin e Projektit të Kontraktuesit në të gjitha aspektet që kanë lidhje me cilësinë dhe Kontrollin e Cilësisë së Punimeve duke përfshirë dhe përgjegjësinë dhe autoritetin për të ndaluar punën e cila nuk është në përputhje me Kontratën dhe të drejtojë heqjen e punës së kryer jo të duhur nga Kontraktuesi apo nga të nënkontraktuarit e tij ose agjentët e tij).

3. Ndryshimet Organizative

Kontraktuesi do të marrë miratimin e Menaxherit të Projektit përpara se të ndryshojë apo zëvendësojë Menaxherin KC.

2.3 Dokumentacioni KC

Menaxheri KC do të mbajë të dhëna të veprimeve për kontrollin e cilësisë, të testeve të kryera, duke përfshirë këtu edhe punën e të nënkontraktuarve dhe furnitorëve. Këto të dhëna do të jenë në formën e një rapori ditor të pranueshëm nga Menaxheri i Projektit.

2.4 Testet QC dhe provat

1. Te pergjithshme

Disa nga kerkesat dhe vlerat limit jane dhene ne Specifikime mbi bazat e materialeve dhe forcen punetore qe do merret. Mbetet pergjegjesia e Kontraktorit qe te siguroje mire faktin qe kerkesat e specifikuara dhe vlerat limit te jene ne perputhje te plote me keto.

Kostot qe sigurojme mire kete perputhje me Specifikimet do jete te sakta qe te percaktojne vlerat qe mbulon Kontraktori per ushtrimin e punimeve.

Menaxheri I projektit do urdheroje keto prova qe te jete I sigurt per te kontrolluar sa me mire perputhshmerine e tyre me Specifikimet e materialeve dhe punimeve te Kontraktorit. Kosto e ketyre testeve do behet kerkese e shpeshhershme nga Kontraktori.

Menaxheri KC do të mbajë të dhëna të veprimeve për kontrollin e cilësisë, të testeve të kryera, duke përfshirë këtu edhe punën e të nënkontraktuarve dhe furnitorëve. Këto të dhëna do të jenë në formën e një rapori ditor të pranueshëm nga Menaxheri i Projektit.

Pavarësisht përputhjes me Specifikimin në bazë të fushës ose të testeve laboratorike, materialet ose puna e paraqitur do të refuzohen, kur tiparet e tjera (të cilat nuk janë të kontrolluara në fushë, apo me metodat e testimit laboratorik) nuk përputhen me kërkesat e Specifikimeve, apo kur ka të tjera për shkak të refuzimit si për shembull mangësi të mjeshtërisë, ose tipare të ndryshme të tepruara, shenja të dalluesme të mjeshtërisë së varfër dhe vlerësime të tjera të ndieshme të cilat përbëjnë bazën e mjaftueshme për refuzimin e punës pa anjë testim të mëtejshëm.

2.5 Inspektimet

▪ Kujdesi per bimet

Aktivitetet e vazhdueshme do te inspektohen me qellim qe te sigurohet perputhshmeria me kerkesat e kontrates. Bimet te cilat trajtohen ne nje menyre qe nuk perputhet me keto specifikime do te deklarohen “drure dhe shkurre jashte standardit” dhe do te jene ne ngarkim te kontraktorit.

▪ Cilesia e mbjelles

Cilesia e perzgjedhjes se vendit te mbjelles, vendndodhja e pemeve, thellesia e mbjelljes dhe rrenje te ekspozuara, pozicioni dhe demtimi i levores se trungut ose thyerja e kercenjve, qendrueshmeria, hija, hapesirat, orientimi I gropes se mbjelljes, konfigurimi i rrenjes, demtimi i sistemit rrenjor, materiale te huaja ne gropen e mbjelljes, token e shkrifet ose xhepa ajri.

Inspektimi është i ndarë në dy kategori:

- Inspektim në terren;
- Inpektimi jashtë terrenit.

1. Inspektimi në terren

Inspektimi në terren ose në punë do të kryhet brenda ose në afërsi të sitit të projektit i cili kur kryhet rregullisht në terren (dhe/ose ndonjë tjetër lehtësi kontrolli në vend të cilat miratohen nga Menaxheri i Projektit) rezulton në përputhje të plotë me Dokumentat e Kontratës të të gjithave në vendin e punës.

2. Inspektimet jashtë terrenit

Kontrata mund të përfshijë kontrollet jashtë terrenit dhe inspektimin për pajisjet dhe materialet e identifikuara në Specifikime. Inspektimi jashtë terrenit do të realizohet në prani të Menaxherit të Projektit.

Kontraktori do të japë shënimin e posacëm me shkrim tek Menaxheri i Projektit në jo më pak se 28 ditë përpara se shërbimet e inspektimit jashtë vendit të kërkohen dhe do të sigurojë për prodhuesin, ose fabrikantin një hyrje të sigurtë dhe lehtësi si dhe të bashkëpunojë me personelin e inspektimit në përmbushjen e detyrave të tyre.

2.6 Inspektimi final

Përpara përfundimit real të Punëve dhe përpara inspektimit nga Menaxheri i Projektit, menaxheri i KC do të drejtojë një inspektim të punës dhe zhvillimit sipas listë së ndonjë artikulli i cili nuk është konform me planet dhe specifikimet. Një listë e tillë me mangësi do të përfshihet në dokumentacionin e KC dhe do të përfshijë datën e llogaritur në të cilën do të korrigjohen mangësitë. Menaxheri KC ose stafi do të bëjë një inspektim përfundimtar për të siguruar që të gjitha mangësitë janë korrigjuar dhe kështu të njoftojë Menaxherin e Projektit.

Pas përfundimit të korrigjimit të mangësive të identifikuara nga inspektimi i KZ, Kontraktori mund të aplikojë për Certifikatë të Përfundimit të Punimeve në përputhje me dispozitat e GCC-së.

2.7 Njoftimi për mos përfundim

Menaxheri KZ do të njoftojë Menaxherin e Projektit dhe Përfaqësuesin e Kontraktorit për do mospërmbushje të dalluar me kërkesat sipër përmendura.

Përfaqësuesi i Kontraktorit me marrjen e një njoftimi të tillë do të ndërmarrë menjëherë veprim korrigjues. Nëse Kontraktori nuk e përmbush detyrën si duhet apo refuzon të bëjë këtë gjë, Menaxheri i Projektit mund të nxjerrë një urdhër për të ndaluar të gjithën ose një pjesë të punës derisa të ndërmerret një veprim korrigjues i kënaqshëm. Koha e humbur nga këto urdhra ndalesash nuk do të bëhet subjekt i pretendimeve për zgjatje afati apo për kosto shtesë apo dëmtime nga Kontraktori.

2.8 Matja dhe Pagesa

Kontraktori është plotësisht përgjegjës për të gjitha testet e kërkuara për të siguruar kënaqësinë që materialet që ai furnizon dhe puna që bën është në përputhje me Specifikimin. Kontraktori është plotësisht përgjegjës për të gjitha kostot e një testimi të tillë.

Laboratori testues i pavarur është në të mirë të Kontraktorit për ta lehtësuar nga nevoja e marrjes së pajisjeve të shtrenjta e shpesh shumë të përdorura në shesh për të bërë teste që nuk kërkohen rregullisht. Kostoja e testeve të tilla, apo e grupeve të testeve të tilla, do të mbarten nga Kontraktori. Kostoja e shoqëruar e mostrave, transportit të mostrave, dhënia e ndihmës dhe gjëra të tilla do të jenë vetëm në përgjegjësi të Kontraktorit.

3. MENAXHIMI MJEDISOR

3.1 Pershkrimi

Punedhenesi merr persiper te mbroje ambientin dhe te drejtorje aktivitetin e tij te perditshem ne nje menyre ekologjikesht pergjegjese dhe te ndaloje apo pakesoje ne minimum efekte te mundshme ambientale negative te lidhur me ndertimin e rruges.

Kontraktuesi eshte I detyruar te respektoje te gjitha rregullat, politikat dhe procedurat ne fjale te ambientit percaktuar nga ligjet dhe rregullat.

Nese nje plan menaxhimi mjedisor (PMM) eshte perpunuar , zhvilluar per kete kontrate, kontraktuesi eshte I detyruar te zbatoje dispozitat PMM si dhe gjithe procesin e ndertimit. Kontraktuesi eshte I detyruar te zbatoje kushtet e lejes se mjedisit.

Apo nese nuk ekziston nje PMM, kontraktuesi duhet te kenaqe totalisht kerkesat e treguara sa vijon.

Ne rast se ka nje konflikt te qarte mes ketyre dispozitave dhe atyre te cfaredo PMM, keshtu qe dominon PMM.

Shume nga kerkesat ambientale jane te perfshira direkt ne pika specifike , megjithate kontraktuesi eshte njoftuar se cdo pike sa poshte vijon duhet te jene korrektesisht te vezhguara ne te gjitha zbatimet e projektit dhe te gjithe kostot e mbledhjes , te gjitha kostot e mbledhjes ambientale jane konsideruar te jene perfshire tek kontraktuesi te kuotuar taksa cmime ,ku ekziston nje mundesi per te paguar .

Punedhenesi rezervon te drejten e autorizimit te pavarur te monitorimit te ambientit qe zhvillohet gjate gjithe periudhes se punes .monitoruesit do te referojne shkelje te dukshme te kerkesave ambientale punedhenesit dhe inxhinierit ,stafi inxhinierik dhe per te monitoruar kerkesat ambientale dite pas dite.

Mungesa respective e informacionit ambiental . kerkesa qe jane te lidhura per te paguar sjell pagimin e nje artikulli te tille qe ruhen derisa gabimet ndalohen dhe lidhur me te cdo lloj demi mjedisor eshte zgjidhur krejtesisht.

3.2 Ngjeshje te panevojshme te dheut/terrenit

Do perdoret cdo orvatje per te evituar ngjeshje te panevojshme te terrenit
Ne rastet kur ngjeshje te tille jane te paevitueshme p.,sh hyrje te perkohshme ne zona apo fusha , kontraktuesi merr te gjitha masat e nevojshme qe terreni eshte I lire per te gjithe thellesine e ngjeshjes para procesit te rigjallerimit.

3.3 Mbeturinat e vajit, karburantit dhe materialeve bitumizone

Vajrat lendet djegese materiali bituminoz duhet te jete sistemuar dhe vendoset ne nje menyre te miratuar nga autoritetet mjedisore
Te tilla materiale ne cdo rast nuk duhen aliminuar apo abandonuar.

3.4 Pluhuri

Rruga te pashtruara jane rregullisht te holluara me uje per te eleimuar pluhurin e shkaktuar nga trafiku ndertimeve
Vaditja e rregullt me ane te vaditjes ne nje frekuence te mjaftushme te garantoje qe siperfaqja ku ecet te jete gjithnje e njome ndersa rruget jane te zena nga trafiku ndertimit.

3.5 Ngarkesa e shtresave/ambalazheve

Te gjithe kamionet qe transportojne materiale te imet apo material qe mund te lejojne pluhur kane ngarkesen e tyre te ngjeshur me tende.

3.6 Emetimet

Pajisjet per ndertim duhet te mbahen ne menyre adeguate me qellim qe te garantojne qe nxjerrjet jane Brenda tolerancave te publikuara te prodhimit
Impiante asfalti duhet te paisen me nje sistem filtrimi te pluhurit dhe nuk do lejohen nxjerrje jo sinjifikative te pluhurave.

3.7 Nivelet e zhurmave

Paisje me nivel te larte te zhurmes duhet te limitohen per te punuar nga 08:00-18:00 dhe do menaxhohen vetem ne ditet normale te punes
Frenimi I nivelit te zhurmes mund te zbutet nga Inxhinieri nese ai eshte I bindur se pozicioni I influencuar eshte krejtesisht larg rrezes degjimit dhe nga cdo komunitet potencialisht I influencuar
Niveli I larte I zhurmes se paisjeve duhet te karakterizohen si paisje qe prodhojne nje nivel zhurme me te larte se 90db ne nje distance 10 m ne kushte normale pune
Ne se eshte drejtuar keshtu, kontraktuesi perdor barriera antizhurme per te mbrojtur sektoret kritike (shkolla spitale etj) nga efektete nivelit te larte te zhurmes.

3.8 Materiale te rrezikshme

Te gjitha materialet e rrezikshme apo te fuqishme (te perfshire por jo te limituar karburanteve , vajrave,materialet bituminoze,cimento) do te mbahen ne kapanone te caktuara ose ndertesa me mbrojtje te plote nga efektet e mundshem te rrjedhjeve apo nga shperberja.

Te gjitha plehrat apo material I mbetur duhen te hidhen duke perdorur procese te miratuara te garantuara te mos shkaktojne efekte te semundjeve ambientale.

3.9 Rruget e aksesit

Te gjitha hyrjet ne zonat e perkohshme te zena nga ana e kontraktuesit duhet te jene te drejtuara me qellim evitimin e demeve mjedisore

Te tilla rruge duhet te aprovohen nga Inxhinieri para se te krijohen

Nese e sheh te arsyshme inxhinieri miraton dhe jep keshilla nga pikpamja ambientale para aprovimit te te tilla rugeve.

3.10 Pemet per t'u prere

Kontraktuesi ne cdo moment duhet te marre ne kohe te gjitha masat e nevojshme per te minimizuar shkaterrimin e pemeve dhe bimesise

Duhet te siguroje qe personeli tij ne cdo kohe te mos marre persiper prerjen e paautorizuar te pemeve apo te hapsirave.

3.11 Aksesit ne prona

Te gjitha hyrjet e pronave ekzistuese , rruget duhet te respektohen ne cdo moment te zbatimit te punimeve.

Kudo qe prona ka nje hyrje ekzistuese kontraktuesi duhet te siguroje permes disponibilitetit te punimeve te perkohshme adeguate qe kjo hyrje mbetet ne dispozicion te pronarit te prones gjate punimeve.

3.12 Masat dhe pagesa

Pagesa e pajtimit te kontraktuesit me Plan e menaxhimit mjedisor jane te mbuluara nga shuma e treguar per menaxhimin ambiental ligja 1 te project ligjit te sasive(fatura e sasive)

Pagesa e kesaj shume do te jete Brenda vleres 7% te shumes se cituar ne cdo fature deri ne 84% te shumes qe eshte paguar.

Nuk do kete asnje pagese tjeter deri ne faturen perfundimtare e cila perfshin mbetjen prej 16% apo te cdo shume te madhe mbetese

Pagesa e fatures finale permban nje shume per tu paguar ne shumen e detyrueshme per menaxhimin ambiental do jete kontigjent ne te gjithe vendodhjen duke kenaqur dhe duke plotesuar standartet e ketij pershkrimi dhe ne perputhje me te gjitha kerkesat e planit te menaxhimit ambiental dhe lejes ambientale.

3.13 Mbrojtja e sendeve qe jane projektuar te rrijne perseri

Ne zona te projektuara nga menaxheri I projektit, kontraktuesi do te jete pergjegjes per mbrojtjen e shkurreve ekzistuese, pemeve dhe siperfaqeve me gjelberim/bar. Me mbarimin e punimeve keto zona do ti rikthehen ndermarresit ne te njejtat kushte si me pare dhe ndonje dem si pasoje direkte apo indirekte e veprimeve te kontraktuesit nuk do te jete kosto shtese e ndermmaresit.

Te gjitha kalimet ekzistuese te kembesoreve, trotuaret, gardhet, muret, pemet, shkurret, lendinat, apo te tjera qe thote menaxheri I projektit nuk do te hiqen apo perndryshe duhet te merren masa dhe te ruhen nga demtimi. Cdo demtim qe ndodh si pasoje e deshtimit te kontraktuesit per te marre masat paraprake te

duhura, do te riparohet me shpenzimet e kontraktuesit.

Artikujt/sendet e pronës private do te mbesin ne vend (ndertesa, gardhe, kanale kullimi, ujitjeje, uje apo tubacione per sherbime gazi, kanale, vrima, mure, kryqezime kanalesh etj) do te mbrohen me kudes nga demtimet dhe zhvendosjet.

3.14 Grumbullimi i materialeve te pastruara

1. Pronesia e materialeve

Pervец nese kerkohet ndryshe ne dokumentat e kontrates, te gjitha materialet e hequra nga kontraktuesi do te rrijne pronesi e kontraktuesit dhe do te hidhen ne perputhje me kerkesat e ligjit te shtetit, planit te menaxhimit mjedisor, kerkesat e ketij specifikimi dhe instruksionet e menaxherit te projektit.

2. Djegja e coperave

Aty ku lejohet djegja e ketyre lloj materialeve, te gjitha keto djegje do te jene subjekt I ligjeve te aplikueshme, urdheresave dhe rregulloreve dhe duhet te behen ne vende ku pemet dhe shkurret afer zones se pastruar nuk do te demtohen.

Aty ku djegja lejohet me ligj, urdherese, ose rregullore, kontraktuesi do te hedhe materialin Brenda zonave te siguruara nga aid he te aprovuara nga menaxheri I projektit.

3. Hedhja ne zona afer projektit

Materialet mund te hidhen ne nje prone private duke u siguruar nga menaxheri I projektit qe ai ka nje aprovim te shkruar nga pronari I pronës I cili jep lejen per hedhjen e materialeve ketu. Te gjitha zonat e hedhjes per materiale qe rezultojne nga pastrami dhe shkulja, qofte ne prone private apo ne prone te poseduar nga kontraktuesi, do te jene ne zona larg pamjes se projektit dhe te pakten 100m larg nga kufiri I rruges me te afert te automjeteve. Nese materialet do te digjen , duhet nje dimension zone prej 100m. ne asnje menyre kjo mase nuk heq pergjegjesine e kontraktuesit per te hedhur materiale ne perputhje me ligjet e shtetit, planin e menaxhimit mjedisor dhe me kerkesat e ketij specifikimi.

4. Nivelimi I terrenit

Brenda cdo zone mes kufijve te ndertimit dhe kufijve te jashtem te pastrimit dhe shkuljes, te gjitha gropat dhe vakumet tjera do te mbushen dhe te gjitha pirgjet be dheut kreshtat do te priten. Zonat do te sillen ne kontru unifom te mjaftueshem ne menyre qe mbushja dhe shkurtimi vijues te mos pengohen nga parregullsia e terrenit. Kjo pune do te behet pavaresisht nese parregullsia jane rezultat I veprimeve te kontraktuesit apo ishin ekzistente ne menyre origjinale.

3.15 Masat dhe pagesa

Pagesa per punen e specifikuar ne kete paragraph te specifikimit do te behet sipas fatures se sasive te matur sipas karakteristikave te kuotuar duke perdorur njesite e matjeve te specifikuara.

Pagesa per te gjithë artikujt te pa-projektuar ne menyre specifike ne faturen e sasive, do te mendohet qe te perfshihet ne shumat e kontraktuesit.

4. PUNIMET ME DHERA

4.1 Pershkrim

Punimet e specifikuara ne kete paragraph mbulojne germimet dhe argjinaturat e kerkuara per ndertimin e anave te xhades dhe rruges se automjeteve dhe per kanale te reja kullimi.

Te perfshira ne germime, sipas ketij paragrafi, jane materialet qe hasen brenda limiteve te kerkuara te germimit (pervec sa mund te specifikohet ndryshe per tu hequr sipas punes se pastrimit dhe shkuljes dhe nxjerrjes se shtresave te punueshme ose sipas pikave qe lidhen me heqjen e ketyre materialeve).

Germimi dhe rimbushja e lidhur me gropen ose riparimin e ngastres, pastrimin e kanaleve te kullimit dhe kanaleve nen-rrugore, puna e faturuar ne menyre specifike si germin sstrukturor dhe rimbushje strukturore, nuk do te perfshihet ne kete pershkrim pune.

E gjitha puna sipas ketij paragrafi do te jete ne perputhje me radhitjet, nivelet dhe detajet e treguara ne paragrafet tipike ose sic mund te udhezohet ndryshe. Nese veprimet ekspozojne produkte (te bera nga njeriu) me domethenie historike ose arkeologjike, germimet do te shkeputen perkohesisht dhe rasti do ti kalohet me shkrim menaxherit te projektit. Germimi do te rifilloje vetem kur te udhezohet me shkrim nga menaxheri I projektit.

Kontraktuesi do te jete plotesisht pergjegjes per masat e te gjitha materialeve te kerkuara per punimet tokesore.

4.2 Klasifikimet

Germimi I specifikuar sipas ketij paragrafi do te klasifikohet si I pergjithshem, material I papershtatshem dhe si germim kanalesh.

1. Germimi I pergjithshem

Germimi I pergjithshem do te perfshije germimin e rruges se automjeteve dhe germimin e marre hua sic specifikohet me poshte.

Germimi I rruges se automjeteve

Germimi I rruges se automjeteve do te konsistoje ne germimin dhe vendosjen tek argjinaturat (te hedhjeve te kenaqeshme) e te gjithë materialit te nevojshem per ndertimin e punime tokesore te treguar tek skicat duke perfshire cdo ulje tek pjerresite ekzistuese te argjinaturave. Aty ku germimi ne nje rruge automjetesh kerkohet ne nje nivel specific dhe kontraktuesi germon nen nivelin e kerkuar, ky mbi-germim do te behet duke perdorur material te aprovuar, me cilesi jo me te paket sesa materiali I mbi-germuar me shpenzimet e kontraktuesit.

Germimi ne gurore

Germimi I pershtatshem do te konsistoje ne germimin, transportin dhe vendosjen ne argjinature te materialit nga burime te autorizuar te marrjes hua. Ajo do te perfshije vetem material qe eshte I pershtatshem per ndertimin e argjinaturave apo te punimeve tjera te mbuluara nga kontrata, dhe, ku specifikohet keshtu, do te jete ne perputhje me kerkesat e skicave dhe te ketyre specifikimeve.

4.3 Hedhja e materialeve te teperta dhe te papershtateshme

1. Pronesia e materialeve te germuara

Cdo material I tepert do te behet pronesi e kontraktuesit dhe do te vendosen jashte RoW me pelqim te menaxherit te projektit dhe ne perputhje me ligjet e shtetit, me planin e menaxhimit mjedisor, dhe me kerkesat e kesaj specifike. Kostot per keto hedhje/vendosje do te mbulohen teresisht nga kontraktuesi I cili do ti beje zbritje ne shumat e tij te germimit.

Ne zona urbane apo ne zona te tjera ku ruajtja e perkohshme e materialeve te pershtateshme brenda objektit mund te jete e papraktikueshme, kontraktuesi do te inventarizojte materialet ne zona te siguruara nga aie derisa keto materiale te nevojiten ne pune ose te behet te teperta. Me aprovimin me shkrim te materialit shtese te dukshem, me kuptimin qe cdo pjese e materialit te vendosur qe ne vijim mund te kerkohet per te plotesuar mbushjen apo kerkesa te tjera te projektit – do te zevendesohet me materiale te ngjashme pa sanje kosto te ndermarresit.

Nese materialet do te inventarizohen perkohesisht me shpenzimet e kontraktuesit, asnje pagese shtese nuk do te behet dhe asnje kompensim nuk do te lejohet per ndonje ri-trajtim te perfshire.

2. Hedhja / Zonat e mbeturinave

Derisa te behet ndonje lejim tjetër, kontraktuesi do te hedhe te gjithë materialin e tepert te germuar, duke perfshire materialin e papershtatshem, jashte zones se projektit ne zona te aprovuara te mbeturinave nga pushteti lokal. Kontraktuesi do ti pajise zonat e hedhjes pa kompensim shtese dhe do ti identifikojë ata dhe metoden e propozuar te hedhjes per aprovim nga ana e menaxherit te projektit. Kjo do te jete te pakten 30 dite nga hapja e zones se hedhjeve te mbeturinave.

Zonat e siguruara nga kontraktuesi per hedhjen e materialeve te hequra do te jene larg pamjes se projektit dhe te pakten 100 m distance do te aplikohet nga rruga publike me e afert dhe kufiri i objektit. Kufiri prej 100m nuk do te zbatohet, sidoqofte, nese materiali eshte hedhur sic duhet, eshte kompakt, lene dhe ngecur ne perputhje me nje skeme te projektuar ne menyre specifike per zonen e cila ka qene e aprovuar nga menaxheri I projektit dhe nga autoritetet lokale kompetente.

4.4 Zona e Inerteve

1. Autorizimi per Guroren

Eshte pergjegjesi e kontraktuesit per te identifikuar zona te pershtatshem per tu marre hua per aprovim nga menaxheri I projektit dhe kontraktuesi do te beje perdorimin maksimal te zonave ekzistuese te marra me hua. Ne asnje rast nuk do te merret hua materiali derisa te bihet dakord keshtu nga menaxheri I projektit dhe me pas vetem nga zonat e inerteve te aprovuara ne perputhje me kerkesat e ligjit te shtetit, me planin e menaximit mjedisor, dhe me kerkesat e ketij specifikimi. Asnje zone e inerteve nuk do te hapet derisa menaxheri I projektit te kete aprovuar vendndodhjen e tyre dhe metoden e restaurimit qe do te perdoret. Puset e marra me hua do te vendosen prapa rruges ne anen e pasme te pakten 100 metra.

Kontraktuesi do te beje te gjitha perpjekjet per te perdorur puset e marra me qira per masen e materialit tek limiti dhe te lehtsoje ndikimin mjedisor. Menaxheri I projektit mund te instruktoje kontraktuesin qe te perdore zonen ekzistuese te marre hua nese per mendimin e tij perdorimi I kesaj zone e limiton ndikimin mjedisor. Nuk do te merret parasysh asnje ankese kur kontraktuesi te jete instruktuar per te perdorur nje zone ekzistuese te marre hua.

Asnje material I marre hua nuk do te merret nga ndonje zone zevendesuese derisa kontraktuesi te kete bere kerkese me shkrim per lejeim per te perdorur te tilla zona dhe menaxheri I projektit ta kete aprovuar me shkrim perdorimin e zonave te vecanta. Me kete aprovim me shkrim nga menaxheri I projektit, zonat e zevendesimit do te konsiderohen si zona te marra hua 'te percaktuara' shtese.

Perverc rasteve te ekzistences se burimeve tregtare, kontraktuesi duhet ta pajise ndermarresin me evidence qe te gjitha lejimet e nevojshme, te drejta apo doreheqjet per perdorimin e ndonje zone te marre hua jane siguruar.

Me mbarimin e germimit, te gjitha zonat e ekspozuara, duke perfshire rruget me gropa, do te marrin forme e menyre te rregullt dhe do te vishen ne menyre te tille qe te mos paraqesin nje paraqitje te pakendeshme. Kostoja e mbjelljes se barit dhe e masave te kontrollit te erozioneve tjera te perhershme – sic mund te drejtohen nga menaxheri I projektit- do te perfshihen ne koston e punimeve.

Nje heqje dore nga kerkesa e pengeses 100m, do te merret parasysh vetem ne rrethana te rralla dhe te pazakonshme aty ku do te rezultojte nje perfitim publik definitiv. Cdo kerkese e tille per te kaluar kufijte e pengeses se 100m duhet te shoqerohet nga plani I propozuar I kontraktuesit per pamjen dhe restaurimin e zonave te turbullta duke I perzier me terrenin rrethues. Kostoja per te gjitha punen e pamjes dhe restaurimit te kerkuar si pasoje e kalimit te kufirit mbi pengesen 10m, do te jene tek shpenzimet e kontraktuesit.

2. Pergatitja e terreneve per inerte

Përpara se të nisë nxjerrja e materialit të gërmuar nga zonat e gurores, pjesa sipërfaqësore e dheut së zonës që do të gërmohet duhet të hiqet deri në thellësinë prej 200mm, ose një thellësi tjetër, sipas urdhërit të Menaxherit të Projektit, duke



patur parasysh thellësinë përkatëse të bimëve dhe lëndëve organike si dhe përdorimin në të cilin do të hidhet materiali i gurores. Dheu i hequr nga sipërfaqja duhet të vendoset mënjane dhe të rezervohet për rregullimin përfundimtar të zonës se inerteve.

4. Rrugët e furnizimit të materialeve për Zonat e Inerteve

Kontraktuesi duhet të ofrojë dhe të ruajë me shpenzimet e tij të gjitha rrugët e përkohshme apo të përhershme, që do të përdoren për sjelljen e materialeve te gurores. Kur këto rrugë furnizimi përdoren nga të tjerë, Kontraktuesi nuk duhet të lejojë që këto rrugë të prishen, për shkak të veprimtarisë së tij.

Kontraktuesi duhet të marrë masat e veta për përdorimin e të gjitha rrugëve jo-publike të furnizimit, të cilat prekin pronat e të tjerëve. Çdo shpenzim për përdorimin e këtyre rrugëve të furnizimit të përfshihet në përgjegjësinë e Kontraktuesit.

5. Rikthimi në Kushtet e Mëparshme i Zonave te Inerteve

Kur veprimet e nxjerrjes për qëllimet e Punimit, në të gjitha zonat e inerteve që janë hapur nga Kontraktuesi për qëllimet e Punimit, të kenë përfunduar, gropëza duhet të mbyllet dhe të rikthehet në kushtet e mëparshme. Nëse gropëza është nuk është gropëz drenazhimi, siç përshkruhet në paragrafin 3 më sipër, gropëza duhet të mbushet. Nëse gropëza është një gropëz e lirë drenazhimi, atëhere duhet të formohet me kujdes dhe të shkallëzohet, për të përfutur formën, sipas marrëveshjes me menaxherin e projektit dhe në mënyrë të tillë që asnjë front i pjerrët të mos tejkalojnë pjerrësinë normale të fronteve në terrenin përreth. Pas përfundimit të mbushjes apo rigradimit, e gjithë zona e ndikuar duhet të mbulohet me një shtresë uniforme dheu sipërfaqësor, me përdorimin e materialit të ruajtur mënjane kur u hap gropëza. Shtresa sipërfaqësore e dheut duhet të mbillet me fara, të bar apo të bimëzohet në ndonjë mënyrë tjetër, të pranueshme nga Menaxheri i Projektit, dhe të përlllogaritur që të sigurohet bimëzimi i duhur i të gjithë zonës brenda 6 muajsh nga përfundimi i rikthimit në kushtet e mëparshme.

Pas përfundimit të rikthimit në kushtet e mëparshme, asnjë zonë e gropëzuar nuk duhet të lihet në mënyrë të tillë, që të jetë në gjendje të mbajë ujëra të ndenjura.

4.5 Materialet per Argjinaturen

1. Kërkesa te Pergjithshme

Fjalët “mbushje” dhe “argjinaturë” përdoren në mënyrë zëvendësuese të njëra – tjetrës në këto Specifika.

Materialet e përdorura për ndërtimin e mbushjeve nuk duhet të përmbajnë cungje, rrënjë, zgorre, lëndë bimore, plehra apo materiale të tjera që nuk mund të kompaktësohen në një strukturë të fortë e të përshtatshme. Materialet e përcaktuara si të papërshtatshme duhet të hiqen dhe të hidhen poshtë. Ndërtimi i mbushjes apo argjinaturës duhet të kryhet në përputhje me Planet ose sipas urdhërave të Menaxherit të Projektit. Materiali i mbushjes nuk duhet të përmbajë pjesëza më të mëdha se 150mm, përveç nëse Menaxheri i Projektit e pranon një gjë të tillë.

2. Mbushje e Përzgjedhur Posaçërisht.

Në rastet kur mbushja e përzgjedhur posaçërisht paraqitet në plane ose urdhërohet nga Menaxheri i Projektit, materiali i përdorur duhet të jetë i tillë, që të ofrojë një ndërtim të qëndrueshëm me depërtueshmëri të ulët dhe duhet të ketë miratimin e Menaxherit të Projektit.

3. Përmbajtja e Lagështisë.

Materialet duhet të kompaktësohen në përmbajtjen optimale të lagështisë, në mënyrë që të arrihet dendësia e përcaktuar në specifika. Nëse është e domosdoshme, për të arritur përmbajtjen e lagështisë, materialit duhet t'i shtohet ujë ose përmbajtja e lagështisë duhet të ulet duke e punuar materialin dhe / ose duke formuar grumbuj materiale, në mënyrë që t'i mundësohet tharja, siç mund të jetë e nevojshme.

4. Kërkesat e Dendësisë.

Çdo shtresë e materialit të përdorur për formimin e argjinaturave duhet të kompaktësohet në një dendësi prej të paktën 95% të dendësisë maksimale, sipas përcaktimit të AASHTO T 180. Çdo shtresë duhet të kompaktësohet në mënyrë uniforme, me përdorimin e pajisjeve që do të arrijnë dendësinë e kërkuar dhe ndërsa veprimet e kompaktësimit vazhdojnë, çdo shtresë duhet të formohet dhe të punohet sipas nevojave, për të siguruar dendësinë uniforme përgjatë argjinaturës. Dendësia e çdo shtrese duhet të testohet me anë të metodës së zëvendësimit të Dheut – AASHTO T176. Në rastet e miratuara nga Menaxheri i Projektit, Kontraktuesi mund të plotësojë metodën e zëvendësimit të dheut me përdorimin e një Instrumenti Bërthamor Matës të Dendësisë, rast në të cilin dendësia në vend e çdo shtrese duhet të përcaktohet sipas specifikave të Standarteve ASTM D-2922, D-3017 dhe/ose C-1040. Në rast se paraqitet mospërputhje midis rezultateve të kontrollit me përdorimin e densimetrit bërthamor dhe zëvendësimit të dheut, rezultatet e zëvendësimit të dheut duhet të konsiderohen si vlera e saktë.

4.6 Klasifikimi i gërmimeve

Të gjitha materialet e gërmuara do të klasifikohen si më poshtë:

Materialet e forta

Materialet e forta janë materialet të cilat si minimum mund të gërmohen vetëm me vënien në përdorim të një thyerësi mekanik me një majë të gurtë në gjendje të mirë pune.

Materialet e Buta

Materialet e buta janë të gjitha ato materiale përveç materialeve të forta që përfshijnë ato që janë të përshtatshme dhe të papërshtatshme për ripërdorim.

4.7 Germimi I themeleve per strukturat

1. Të përgjithshme

Gërmimi i themeleve për të gjitha ndertimet do të mbahet në minimum. Anët e gërmimeve do të mbahen me drurë ose do t'ju vendosen shtylla mbajtëse, pajandra mbështetëse dhe traversa për të parandaluar rrëshqitjen ose vithisjen e tokës rrethuese.

Gërmimi i kanaleve për rimodelimin e kutive të kanalave të nëndheshme prej betoni do të mbahet në dimensionet e specifikuara në Skicat e Kontratës ose siç janë urdhëruar nga Menaxheri i Projektit. Kontraktori do të bëjë furnizime të tilla që të sigurojë sistem kullimi të mirë për kanalet në mënyrë që të mbrohen themelet gjatë punimeve të ndërtimit.

Të gjitha sipërfaqet e gërmuara, materialet e tjera përveç materialeve të forta, mbi të cilat do të vendosen themelet e ndertimeve duhet të jenë kompakte me 95% MDD (AASHTO T99) menjëherë para se të ndërtohen themelet.

Sipërfaqet e gërmuara me materiale të buta do të gërmohen më tej për të arritur një minimum trashësie prej 50mm (2") të Gradës 7 (E) betoni. Aty ku kushtet e tokës janë të tilla që nuk mund të arrihet një themel i kënaqshëm, Kontraktori, nëse udhëzohet nga Menaxheri i Projektit, do të heqë materialin e papërshtatshëm ose derisa të gjendet një material më i përshtatshëm të gjendet, ose në thellësinë dhe gjerësinë e udhëzuar nga Menaxheri i Projektit. Vendosja e materialit shtrues do t'i paraprijë instalimit të kutive të kanaleve të nëndheshme prej betoni. Kjo do të përfshijë nivelimet e nevojshme të fundit të kanalit fillestar ose majën e materialeve të themeleve si dhe vendosjen dhe gradimin e materialit shtrues të kërkuar në një gradë uniforme në mënyrë që e gjithë gjatësia e kanalit të mbahet nga një material mbështetës uniform.

2. Heqja e ujit.

I gjithë gërmimi duhet të mbahet i thatë dhe Kontraktori do t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbajtur gërmimin larg ujit.

Kontraktori do ta mbajë çdo gërmim larg ujit gjatë ndërtimit edhe në rast se ndertimet që do të ndërtohen me kripëra apo me ujë të nëndheshëm acidi, për periudha të tilla kur mund të jetë e nevojshme për të shmangur zhytjen e betonit brenda 14 ditëve të vendosjes së tij.

Metoda për ta mbajtur gërmimin larg ujit, heqja e ujit, do të jenë subjekt i miratimit nga Menaxheri i Projektit. Kontraktori duhet të sigurojë se Impianti i gatishmërisë do të jetë në shesh gjatë gjithë kohës për të shmangur në çdo kohë ndonjë ndërprerje të vazhdimësisë së heqjes së ujit.

Aty ku do të kërkohet nga Menaxheri i Projektit, rezervuarët me të cilët punojnë pompat do të ndërtohen jashtë zonës së themeleve. Pompimi i tepërt nga gërmimi – që rrezikon të

shkaktojë tronditje ose tharje të vijave të tokës aty pranë – nuk do të lejohet.

Aty ku sipas mendimit të Menaxherit të Projektit themeli është bërë i butë dhe duhet ende më tepër gërmim për shkak të mënyrës së punës nga ana e Kontraktorit, rimbushja rezultuese do të jetë në shpenzimet e Kontraktorit.

Metodat e Ndërtimit

Aty ku është e praktikueshme, të gjitha themelet do të ndërtohen nga një gërmim i hapur dhe do të thahen nga uji, lidhen me njëra-tjetrën, ose do të mbrohen nga uji i lumit në përputhje me metodat e miratuara.

Mbrojtëset nga uji ose armaturat për ndërtimin e themeleve do të bëhen në fund të pikëmbështetjeve dhe do të lidhen në mënyrë të sigurtë e do të mbrohen nga uji sa më shumë të jetë e mundur.

Do të ketë një pastrim të mjaftueshëm në brendësitë e kanaleve për heqjen e ujit me qëllim lejimin e ndërtimit të formave dhe inspektimin e pjesëve të jashtme si dhe për pajisjen e pompimit.

Armaturat të cilat janë të pjerrëta ose janë anuar pak gjatë procesit të mbytjes do të zmadhohen me qëllim që sigurohet pastërtia e nevojshme.

Mbrojtja e Betonit

Armaturat do të ndërtohen në mënyrë të tillë që të mbrojnë betonin jeshil kundër dëmtimeve nga një ngritje e menjëhershme e ujit dhe të ndalojnë dëmtimin nga erozioni.

Nuk do të lihet asnjë material lidhës nëpër armatura në mënyrë të tillë që të depërtohet në nënstrukturën e ndërtimit me përjashtim të rastit kur kjo lejohet me shkrim nga Menaxheri i Projektit.

Vendosja në thatësi

Për të vendosur pikëmbështetjet në thatësi, Menaxheri i Projektit mund të kërkojë vendosjen e pjesëve të armaturave në një nivel më të ulët se niveli i fundit të pikëmbështetjeve dhe të kërkojë pajisje pompimi të mjaftueshme për të hequr ujin dhe të mbajë armaturën në kushte thatësie të krahasueshme.

Skicimet e punës

Për punën në nënstrukturë, Kontraktori duhet të dorëzojë skicimet të cilat të tregojnë metodën e propozuar të ndërtimit të armaturës dhe detajet e tjera që i janë lënë në zgjedhjen e tij ose që nuk tregohen plotësisht në Skicimet e Kontratës.

Tipi dhe pastërtia e armaturave deri tani ashtu siç ndikojnë detaje të tilla në karakterin e punës së përfunduar, do të jenë subjekt i miratimit nga Menaxheri i Projektit por detajet e tjera të skicimit do t'i lihen Kontraktorit i cili do të mbajë përgjegjësinë për ndërtimin e suksesshëm të punës.

4. Themelet dhe mbajtëset kundër materialit në vend

Aty ku tregohet në Skicime ose është udhëzuar nga Menaxheri i Projektit që themelet ose mbajtëset do të vendoset kundër materialit në vend, germimi do të bëhet në formën e kërkuar . Nëse ndodh ndonjë germim, hapësira midis themelit dhe / ose mbajtëses dhe materialit në vend do të back-filled me Beton të gradës 15 (D) ose me të njëjtën gradë të betonit si themelet dhe / ose mbajtësja/ Aty ku betoni i themelit dhe / ose mbajtëses do të vendoset kundër një faqeje të mbi germuar, atëherë ajo faqe do të marrë një pjerrësi me një mbigermim minimumi prej 100 mm (4”) nga themeli dhe / ose mbajtësja. Të gjitha këto back-fill do të jenë në shpenzimet e Kontraktorit.

I gjithë betoni i tepërt për mbushjen e faqeve të mbigërmuara do të jetë në shpenzimet e Kontraktorit.

4.8 Rimbushja e germimeve per strukturat

1. E pergjithshme

Nuk do të fillojë asnjë mbushje rreth një strukture apo back filling në kanal; dhe asnjë strukturë nuk duhet të ngarkohet pa miratimin nga Menaxheri i Projektit.

Rendi i mbushjes dhe back filling prapa dhe rreth një strukture dhe maksimumi i diferencës në lartësi midis niveleve të mbushjes duhet të miratohet nga Menaxheri i Projektit.

2. Materiali

Të gjitha materialet e përdorura për back fill do të vendosen ashtu si do të specifikohet më poshtë:

Densiteti

Rimbushja do të depozitohet në shtresa horizontale me një trashësi jo më shumë se 150 mm dhe do të kompaktohet në një dendësi prej jo më pak se 100% e maksimumit të dendësisë siç është përcaktuar nga AASHTO T99.

4.9 Gërmimet për shmangien e lumit

Kontraktori do korrigoje cdo gabim, mosperputhje apo deshtim ne Vizatimet e Punimeve dhe cdo specifike te marre nga ai, nese apo jo keto vizatime dhe vecanti jane ekzaminuar nga Menaxheri I Projektit.

Vizatimet e meposhtme do formojne vizatimet e Punimeve:

- Planet, seksionet dhe ngritjet qe tregojne gjithë punimet e kerkuara, duke perfshire permasen dhe pozicionin.

4. Vizatimet sic ndertohet

Kontraktori do mbaje nje set te vecante shtese te Vizatimeve te Punimeve ne kantier per tu kontrolluar sipas tyre nga Menaxheri I Projektit gjithë rrjedhat e ujrave, pozicionimet e pikave, etj..

Kontraktori do modifikoje keto vizatime punimesh per te patur sa me shume tolerance ne kantier, nderprerje punimesh dhe ndryshime ne shtrirjen e rruges ku parimi dhe ideja e projektit te sherbimeve nuk ndikon. Aty ku parimi dhe ideja e projektit preket, duhet ti behet me dije per konflikt Menaxherit te Projektit.

Menaxheri I Projektit do gezoje te drejten qe cdo kohe kur e sheh te arsyeshme te inspektoje vizatimet e Kontraktorit per cdo porcion punimesh.

Kontraktori do paraqese Vizatimet e Punimeve qe jane shenuar dhe gjithë informacionin tjeter qe reflekton ecurine e gjendjes se punimeve, 'sic ndertohet' ne intervale te rregullta, apo sic kerkohet nga Menaxheri I Projektit.

Kontraktori eshte pergjegjes per gjithë gabimet, mosperputhjet dhe devijimet e shenuara ne vizatime qe kane ndermend te tregojne statusin e punimeve 'sic ndertohet'.

Ne perfundim te Punimeve Kontraktori do pergatise dhe paraqise vizatimet "sic ndertohet" ne kater (4) sete qe pasqyrojne gjithë projektimet, modifikimet dhe ndryshimet e mesiperme.



8. INSTALIMET MEKANIKE, HIDRAULIKE DHE SANITARE

8.1 Sistemi i furnizimit me ujë të pastër

8.2 Tuba

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave mund të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin e tubave) ose mund të përdoren tuba xingato që janë konform standarteve të mësipërme për cilësinë dhe testimin e tyre. Theksojmë se tubat prej PPR janë afro 15 herë më të lehtë se tubat e çelikut.

Tubat për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe rezistencë ndaj ujit të ngrohtë.

Vetitë e tubave PPR duhet të jenë si më poshtë:

- | | |
|---|-----------------------|
| • Densiteti i materialit PPR | 0,9 g/cm ³ |
| • Pika e ngjitjes | 146 gradë celsius |
| • Konduktiviteti termik në 20 gradë | 0,23 W/m.K |
| • Koeficienti i zgjerimit termik linear | 1,5 x 0,0001 K |
| • Moduli i elasticitetit në 20 gradë | 670 N/mm ² |
| • Sforcimi gjatë rrjedhjes në 20 gradë | 22 N/mm ² |
| • Sforcimi i thyerjes në 20 gradë | 35 N/mm ² |

Diametrat e tubave do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të pijshëm dhe shpejtësisë së lëvizjes. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes duhet të merret në intervalet 0,8-1,4 m/sek.

Gjatësia e tubave është 6-12 m, kurse diametri dhe spesori duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj, duhet të jepen të stampuara në çdo tub.

Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë më të grupuara dhe mundësisht sa më afër atyre nyjeve që kërkojnë ujë të pijshëm. Ato instalohen brenda në mur. Në rast së gjatësia e shtrirjes së tyre është e madhe duhet të vendosen kompesatorë të tipit me brryl të thjeshtë ose tip omega.

Tubat e furnizimit me ujë lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh në çdo kat me anë të tubave të dërgimit. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit duhet të bëhet me tridegëshe ose brryla. Për të pakësuar numrin e kollonave duhet që pajisjet sanitare të grupohen dhe të vendosen njëri mbi tjetrin nga kati në kat të ndërtesës. Diametri i kollonave vertikale të furnizimit me ujë, merret i njëjtë për të gjithë lartësinë e ndërtesës, me diametër më të vogël se tubi kryesor i furnizimit dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i

dërgimit të ujit të pijshëm që furnizojnë pajisjet.

Linjat kryesore horizontale të furnizimit me ujë vendosen me pjerrësi në ngjitje në drejtim të lëvizjes së ujit jo më pak se 2 %. Largësia midis tubave të kanalizimit që dalin tërthor nga godina dhe të lidhjeve të furnizimit me ujë, duhet të jetë jo më pak se 1 m në plan horizontal dhe gjithmonë në kuotë më të lartë se kanalizimet e ujrave të zeza.

Tubat PPR ngjiten me anë të metodës me elektrofuzion duke përdorur pajisjet përkatëse të saldimit me elektrofuzion. Kjo lloj ngjitje garanton një lidhje të sigurtë, homogjene dhe jetëgjatë. Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion zgjat shumë pak minuta. Gjatë këtij proçesi, prerja e tubave, ngrohja e tyre dhe e rakorderive përkatëse PPR bëhet me pajisje të posaçme ngjitjeje. Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion bëhet si më poshtë:

- Bëhet gati pajisja e saldimit me elektrofuzion dhe veglat e duhura për diametrat e përcaktuara të tubave
- Vihet në prizën e energjisë elektrike pajisja e saldimit dhe kontrollohet llampa e ndezjes, si dhe llampa e punës
- Presim sa të kapet temperatura e saldimit prej 260 gradë celsius
- Shënohet thellësia e saldimit me anë të një lapsi konduktiv.
- Nëse tubat, rakorderitë apo pajisja janë të pista bëhet pastrimi i tyre.
- Fillohet proçesi i ngrohjes dhe saldimit të tubave. Koha e ngrohjes, e proçesit të saldimit dhe e ftohjes jepen në tabelat përkatëse të mëposhtme të aparatit të saldimit.

Diametri i jashtëm i tubit në mm	Koha e ngrohjes Në sekonda	Koha e proçesit të ngjitjes në sek.	Koha e ftohjes në minuta
16 mm (1/2")	5	4	2
20 mm (3/4")	5	4	2
25 mm (1")	7	4	2
32 mm(1.1/4")	8	6	4
40 mm(1.1/2")	12	6	4
50 mm(1.3/4")	18	6	4
63 mm (2")	24	8	6

- Vendoset fundi i tubit tek vrima e nxehur dhe rakorderia përkatëse në anën tjetër të pajisjes. Fundet përkatëse të tubit dhe rakorderisë përkatëse, pasi lihen të ngrohen, siç është treguar në tabelë, bashkohen në gjendjen e nxehur që janë dhe lihen të ftohen për pak minuta (shih tabelën). Duhet të kihet parasysh që për diametra të ndryshëm ka kohë të ndryshme për ngrohjen, saldimit dhe ftohjen.
- Tubi është i gatshëm për t'u përdorur



Në rast se përdoren tubat e xingatos, lidhja e tyre bëhet me filetimit. Gjatë bashkimit, pjesa e filetuar duhet të mbështillet me fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë për të mos patur rrjedhje (qarje).

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

Model i tubit të furnizimit me ujë që do të përdoret së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do t'i jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervizori mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike- termike të tubave, rrjedhje të mundshme, si dhe presionin që durojnë tubat (Testi i presionit bëhet me 1.5 herë të presionit të punës).

8.3 Rakorderitë për tubat e ujit të pijshëm

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave, në rastet kur do të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), rakorderitë përkatëse duhet të jenë PPR të cilat plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin) ndërsa në tubat xingato rakorderitë janë xingatoje.

Rakorderitë që përdoren në këto linja janë:

- Brrylat të thjeshtë me 45 gradë dhe 90 gradë
- Brryla me fileto metalike të tipit femër dhe mashkull;
- Tridegëshat të thjeshtë dhe me fileto;
- Katërdegësha (Kryqe)
- Bashkues të thjeshtë
- Bashkues me fileto metalike tip femër dhe tip mashkull;
- Reduksionet e ndryshme;
- Rakorderi tip hollandez;
- Mbështetëse;
- Kaluesa;
- Kompensator tip omega;
- Tapa.

Llojet e rakorderive që do të përdoren për çdo rast duhet të jepen nga projektuesi në Vizatimet teknike.

Rakorderitë që do të përdoren për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe rezistencë ndaj ujit të ngrohtë.

Vetitë e rakorderive PPR duhet të jenë si më poshtë:

- Densiteti i materialit PPR 0,9 g/cm³
- Pika e ngjitjes 146 gradë celsius

- Konduktiviteti termik në 20 gradë 0,23 W/m.K
- Koefiçienti i zgjerimit termik linear 1,5 x 0,0001 K
- Moduli i elasticitetit në 20 gradë 670 N/mm²
- Sforcimi gjatë rrjedhjes në 20 gradë 22 N/mm²
- Sforcimi i thyerjes në 20 gradë 35 N/mm²

Diametri dhe spesori duhet t'i përshtaten tubave përkatës dhe të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike dhe kushteve teknike (spesori i rakorderive duhet të jetë i tillë që të përballojë 1,5 herë të presionit të punës së tubave). Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të rakorderive (brryla, tridegësh, bashkues, reduksione, etj), presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo copë.

Rakorderitë PPR ngjiten me anë të metodës me elektrofuzion duke përdorur pajisjet përkatëse të saldimit me elektrofuzion. Kjo lloj ngjitje garanton një lidhje të sigurtë, homogjene dhe jetëgjatë. Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion zgjat shumë pak minuta. Gjatë këtij proçesi, prerja e tubave, ngrohja e tyre dhe e rakorderive përkatëse PPR bëhet me pajisje të posaçme ngjitjeje.

Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion bëhet si më poshtë:

- Bëhet gati pajisja e saldimit me elektrofuzion dhe veglat e duhura për diametrat e përcaktuara të tubave;
- Vihet në prizën e energjisë elektrike pajisja e saldimit dhe kontrollonhet llampa e ndezjes si dhe llampa e punës
- Presim sa të kapet temperatura e saldimit prej 260 gradë celsius
- Shënohet thellësia e saldimit me anë të një lapsi konduktiv.
- Nëse tubat, rakorderitë apo pajisja janë të pista bëhet pastrimi i tyre.
- Fillohet proçesi i ngrohjes dhe saldimit të tubave dhe rakorderisë së duhur. Koha e ngrohjes, e proçesit të saldimit dhe e ftohjes jepet në tabelat përkatëse të mëposhtme të aparatit të saldimit.

Diametri i jashtëm i tubit në mm	Koha e ngrohjes Në sekonda	Koha e proçesit të ngjitjes në sek.	Koha e ftohjes në minuta
16 mm (1/2")	5	4	2
20 mm (3/4")	5	4	2
25 mm (1")	7	4	2
32 mm(1.1/4")	8	6	4
40 mm(1.1/2")	12	6	4

50 mm (1.3/4")	18	6	4
63 mm (2")	24	8	6

Vendoset fundi i tubit tek vrima e nxehur dhe rakorderia përkatëse në anën tjetër të pajisjes. Fundet përkatëse të tubit dhe rakorderisë përkatëse, pasi lihen të ngrohen, siç është treguar në tabelë, bashkohen në gjendjen e nxehur që janë dhe lihen të ftohen për pak minuta (shih tabelën). Duhet të kihet parasysh që për diametra të ndryshëm ka kohë të ndryshme për ngrohjen, saldimin dhe ftohjen.

Kur përdoren tubat e xingatosh, lidhja e tyre me rakorderitë përkatëse bëhet me filetim. Rakorderitë në këtë rast janë të gjitha metalike me filetim. Gjatë bashkimit, pjesa e filetuar duhet të mbështillet me fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë për të mos patur rrjedhje.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit.

Një model i rakorderisë së duhur që do të përdoret me tubat e furnizimit me ujë, së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do t'i jepet për shqyrtim Supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervisorit mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike - termike të tyre, rrjedhje të mundshme, si dhe presionin që durojnë pas instalimit (Testi i presionit bëhet me 1.5 herë të presionit të punës).

8.4 Saraçineskat

Saraçineskat janë pajisje të veçanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Me anë të saraçineskave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që i jepet pjesës tjetër të tubit ose ndërprerjen e plotë të rrjedhjes. Saraçineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim ose me fllanxha. Saraçineskat sipas mënyrës së bashkimit me tubat l ndajmë në lloje: me fllanxhë dhe me fileto.

Saraçineskat përbëhen prej pjesëve të mëposhtme:

- Trupi cilindrik prej gize ose bronxi. Në këtë trup duhet të fiksohen fllanxhat përkatëse, të cilat shërbejnë për lidhjen e saraçineskës me tubacionin e rrjetit.
- Disku ose sfera i cili duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e saraçineskës. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj
- Volanti apo leva, e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut nëpërmjet lëvizjes vertikale rrotulluese.
- Kapaku i i saraçineskës, i cili lidhet me anë të bullonave dhe dadove me trupin cilindrik të saraçineskës ose me filetim.

Në vendin e bashkimit të saraçineskës me tubat duhet të vendosen guaino gome

në tipet me fllanxa ose fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë, për ato me fileto, për të mos patur rrjedhje të ujit.

Saraçineskat që përdoren në një linjë ujësjellësi duhet të përballojnë një presion 1,5 herë më tepër se presioni I punës. Ato duhet të përballojnë një presion minimal prej 10 atm.

Saraçineskat duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshtë riparimi dhe transporti, jetëgjatësi mbi 25 vjeçare dhe qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike.

Në raste të veçanta me kërkesë të projektit ose të supervizorit përdoren edhe kundralvalvolat që janë saraçineska të cilat lejojnë lëvizjen e ujit vetëm në një drejtim. Këto duhet të vendosen në tubin e thithjes së pompave apo në tubin e dërgimit të tyre. Gjithashtu ato mund të vendosen në hyrje të çdo ndërtese për të bërë bllokimin e ujit që futet.

Ato janë të tipit me porte, e cila me anë të një çerniere hapet vetëm në një drejtim. Në rast se uji rrjedh në drejtim të kundërt me atë që kërkohet, bëhet mbyllja e saj me anë të çernierës.

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave, në rastet kur do të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), saraçineskat përkatëse mund të jenë PPR, të cilat plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin).

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

Një model i saraçineskës që do të përdoret së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë do t'i jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervizori mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike- termike të tyre, rrjedhje të mundshme si dhe presionin që durojnë pas instalimit (Testi i presionit bëhet me 1.5 herë të presionit të punës).

8.5 Depozitat e ujit

Rezerva e ujit do të jetë në formën e rezervuarit prej beton arme, e gruposur nëntokë dhe që duhet të jenë në përputhje me dimensionet dhe percaktimet të bera në vizatim, duke përfshirë lidhjet, menyren e furnizimit me ujë, tubacionet lidhëse, kapërdërdhjen, galexhantet mekanik etj, si dhe të gjitha kërkesat për të siguruar një funksionim normal.

Rezervuari i mesiperm duhet të sigurojë sasinë e nevojshme të ujit sipas percaktimeve të mesiperm. Volumi i tijë si dhe specifikimet teknike të tjera janë prezantuar në vizatimet përkatëse.

Volumi dhe sasia e rezervuarit eshte llogaritur ne vartesi te kerkesave speciale per mbrojtjen kunder zjarrit, sikurse numri i hyrjeve ne ambiente te vecanta, siperfaqeve qe mbrohen, normave specifike etj.

Materiali i rezervuarit do te jete kompozim i betonit me shufra hekuri, i armuar sipas specifikimeve teknike te inxhinerit konstruktor. Forma dhe dimensionet e tij do te jene sic jane specifikuar ne vizatimin teknik.

Rezervuari i ujit do te kompozohen si me poshte:

Tubacioni i furnizimit me uje, ne hyrje te tubacionit do te montohet grupi i matjes dhe i kontrollit te ujit nga rrjeti;

Tubacione e thithjes per pompen e zjarrit, te ujit, te drenazhimit dhe shkarkimit, ne keto tubo do te instalohen valvola on-off dhe valvola moskthimi;

Tubo shkarkimi qe do te instalohet per pompen e drenazhimit dh te zbrazjes se rezervuareve;

Pompe drenazhi, per cdo eventualitet rrjethje apo infiltrim ujrash nga jashte;

Pompe zbrazje te rezervuareve ne raste pastrimi apo disinfektimi;

Galexhant mekanik, filtra, valvola etj.

Diametrat dhe gjatesite e tubove te mesiperme do te jene ne vartesi te volumit te ujit. Te gjitha lidhjet dhe rrjeti i brendshem eshte dimensionuar ashtu sikurse tregohet ne vizatim. Te gjitha tubot ne kete rast do te pergatiten prej çeliku te galvanizuar.

Rezervuari i ujit sic e specifikuam me lart do te jete betoni dhe plan vendosja e tij do te jete ne pjesen ansore te nderteses. Ndertimi konstruktiv i tij do te behet ne baze te vizatimeve dhe specifikimeve te inxhinerit konstruktor.

Te gjitha punimet e instalimit duhet te kryhen ne menyre perfekte dhe ne perputhje me kerkesat teknike qe kerkohen ne projekt. Perpara konstruktimit te rezervuarit, kontraktori duhet te prezantoje per miratim vizatimet e kantierit, kataloget e paisjeve teknike te nevojshme, çertifikaten e kualitetit, origjinen e mallit, si dhe nje garanci prej 3 deri ne 5 vjete.

8.6 Pajisjet Hidrosanitare

7.3.1 WC dhe kaseta e shkarkimit

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC-ve. Ato jane me material porcelani me te dhenat e standarteve teknike nderkombetare dhe duhet te percaktohen ne projekt nga projektuesi. Ato mund te jene te tipit oriental ose alla frenga. Ne shkolla rekomandohen te tipit oriental WC, ku vendoset direkt ne dysheme dhe montohet llaç çimento sipas udhezimeve te dhena nga supervizori.

WC tip alla frenga perdoren ne kopshte dhe per personelin pedagogjik dhe antikapatet, fiksohen ne dysheme ose ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa

me fileto pa ndeprere veshjen me pllaka te murit. Para fiksimit te tyre duhet te behet bashkimi me tubat e shkarkimit te ujrave. WC mund te jete me dalje nga poshte trupit te saj ose me dalje anesore ne pjesen e pasme te WC. Ne WC me dalje anesore tubi i daljes duhet te jete ne lartesine 19 cm nga dyshemeja.

Ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese eshte nje vrime me diameter minimal 90 mm. Pjesa e siperme e WC-se eshte ne forme vezake ose rrethore ne varesi te kerkeses se projektit, llojit dhe modelit te tyre. WC tip alla frenga jane me lartesi 38-40 cm dhe vendosen sipas kerkeses se projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (Lavaman,bide, etj) duhet te jete te pakten 30 cm.

WC-ja duhet te siguroje percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.


WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te tubit ne forme sifoni. Tubi i lidhjes se WC me tubat e shkarkimit duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te WC (zakonisht ato jane 100-110 mm).

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me uje me ane te kasetes se shkarkimit e cila mund te instalohet direkt mbi WC ose ne mur e ndare nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i ketyre pajisjeve. Kaseta e shkarkimit vendoset ne lartesine rreth 1,5 m lart nga dyshemeja (rasti kur eshte e ndare). Ajo mund te jete porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit te saj duhet te percaktohet ne projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet ne mur me fasheta te forta xingato, me vida dhe tapa me fileto ne çdo 50 cm.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e WC duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimi i WC-ve me tubat e shkarkimit duhet te behet me mastik te pershtatshem per tuba PVC, i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i WC qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimi dhe te garancise do t'i jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Te dhenat teknike te WC duke perfshire edhe modelin e tij, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen ne katalogun perkates qe shoqeron mallin. Supervisor mund te beje testimet plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te tyre.

Ne figurat e meposhtme paraqiten dy tipe WC, ajo tip alla Turke dhe ajo tip alla Frenga.



7.3.2 Lavamanet

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit, gjithmone duhet te parashikohen pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamanet) te cilat sherbejne si vende per larjen e duarve dhe fytyres se femijeve. Lavamanet mund te jene metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose te montuar ne veper. Lloji i materialit perberes te tyre duhet te percaktohet ne projekt nga projektuesi.

8.7

Lavamanet duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim te zhurmave gjate punes, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

Lavamanet e porcelanit dhe mbeshtetesja e tyre fiksohen ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa nderprere veshjen me pllaka te murit. Pas fiksimit te saj ne mur duhet te behet vendosja e rubinetave me tunxh te kromuar



mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit te sifonit dhe tubat e shkarkimit te ujrave. Njekoheesisht lavamani duhet te pajiset edhe me pileten e tij metalike. Pileta duhet te vendoset ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese ku eshte hapur nje vrime me permasat e piletes. Lavamani ka nje grope mbledhese me permasa 40/60 x 36-45 cm ne varesi te llojit dhe modelit te zgjedhur. Permasat e lavamanit jane ne varesi te llojit dhe modelit te tyre Lavamanet vendosen ne lartesi 75- 85 cm sipas kerkeses se projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide,WC, etj) duhet te jete te pakten 30 cm


Lavamanet lidhen me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te piletes, tubit ne forme sifoni prej materiali PVC-je. Lidhja e mesiperme mund te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 40 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur.

Lavamanet lidhen me sistemin e furnizimit me uje me ane te dy tubave fleksibel me gjatesi 30 - 50 cm dhe diameter 1/2 ", te cilet bejne lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me uje te ngrohte dhe ujit te zakonshem. Ne vendin e lidhjes se rubinetit me lavamanin duhet te vendosen gomina te pershtatshme, per te mos bere lejimin e rrjedhjes se ujrave.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimet e lavamanit me tubat e shkarkimit duhet te behen me tubat perkates dhe me mastik te pershtatshem per tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i lavamanit qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimit dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Supervizori mund te beje testime plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te tyre.

Ne figuren e meposhtme paraqitet nje lavaman porcelani, i cili eshte inkastruar ne mur.





7.3.3 Rubinetat

Rubinetat janë pajisje të veçanta që përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Ato vendosen në pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamanë, lavapjata ose bide) dhe mund të jenë të thjeshta (përdoren vetëm për ujë dhe pijshëm) ose të përbera (përdoren për sistemet e ujit të ftohtë dhe të ngrohtë). Për rubinetat e thjeshta mund të referoheni zerit 95 (Saraçineskat). Me anë të rubinetave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që del në pajisjen hidrosanitare si dhe mund të bëhet edhe rregullimi i temperaturës së ujit që përdoret. Rubinetat mund të jenë me material bronxi, gize ose të nikeluara. Ato janë të tipit me sferë ose porte.

Grupi i Rubinetes është tip me lidhje tubi, ose dy lidhje rrethore, i cili përbehet prej pjesëve të mëposhtme:

- Trupi prej gize ose bronxi. Forma dhe lloji i trupit të rubinetes janë të ndryshme. Ngjyra, forma dhe tipi janë të përcaktuara në projekt ose duhet të përcaktohen nga Investitori.
- Disku ose sferë, që duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e rubinetes për ujë të ftohtë ose të ngrohtë duke bërë edhe rregullimin e sasise që del nga rubineta. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj
- Leva e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut.
- Filtri i ujit i cili vendoset me filetimit në dalje të rubinetes dhe siguron pastrimin e ujit nga lëndë të ndryshme minerale apo kriprat që shoqërojnë ujë dhe pijshëm

Tubat fleksibel me gjatësi 30-50 cm të cilët bëjnë lidhjen e rubinetes me tubat e furnizimit me ujë. Tubat fleksibel kanë diametrin 1/2" ose 3/8" në varesi të llojit të rubinetes dhe te tubave

9. DITET E PUNES

9.1 Pershkrim

Menaxheri I Projektit do udhezohet qe te kryhet ne baze te diteve te punes cdo punim shtese apo zevendesues.

Zerat e perkoshem jane perfshire ne Ditet e Punes te Seksioni I Preventivave per te mbuluar pagesen e impiantit, forces se punes dhe materialet e duhura per punime ne perputhje me udhezimet e dhena nga Menaxheri i Projektit vetem ne baze te diteve te punes, pune qe do kryhen nga kontraktori apo nenkontraktoret e tij.

2. Forca Punetore

Pagesat do behen vetem per ate kohe qe perdoret zeri I punes ne terren per dite pune te shpenzuara sic udhezohet nga Menaxheri I Projektit.

Vlerat per force pune do perfshijne kostot e sa me poshte:

- Supervizionin dhe transporti I stafit te supervizorit.
- Cdo kosto per shpenzime ditore per kete force punetore ne lidhje me natyren e punes, vazhdimesine, oret shtese te punes, bonuset, ushqimi, shtepia, pushimet, transporti nga dhe ne vendin e punes, kostot shtese ne lidhje me staf shtese, adminsitrimi I kampit dhe siguracioni e sigurimet.
- Furnizimi, transporti rreth kantierit, shfrytezimi mirembajtja dhe rifreskimi I veglave te vogla qe perdoren gjate diteve te punes, si lopatat, pirunjte, mbajttese, cekice, kocat, mistrite, hekura, dhe gjithe zerat qe kane kete natyre dhe qe nuk jane specifikuar ne ndonje ze te Impinatit te Ndertimit se bashku me veshjen mbrojtese.
- Gjithe kostot e tjera Kontraktori mund ti hedhe ne punesim stafi per pune shtese, perfitime dhe cdo kosto tjeter apo kosto per dite jetese.

3. Materialet

Pagesat do behen vetem per materialet e udhezuara nga Menaxheri I Projektit per shfrytezimin e tyre per dite pune. Pesha e volumet neto dhe zonat e pershtatura nga Menaxheri I Projektit ne perputhje me udhezimet e tij do te maten te gjitha.

Vlerat per materialet do perfshihen per koston e blerjes apo klauzolat per materialet, transportin per ne kantier dhe vendin e diteve te punes, magazinimet, siguracionet, transportet me dore, mbetjet, vendosjet, supervizioni, perfitimet, dhe cdo lloj kostoje tjeter e shpenzime ditore jetese.

10. PEISAZHI DHE BIMESIA

10.1 Qellimi

Ky paragraf mbulon peisazhet e zonave jashte prizmit te rruges, krijimin e bimesise per funksione dhe qellime estetike te tilla qe zonat e tjera te peisazheve mund te kerkojne.

10.2 Materialet

Plehu

Tipi plehut qe duhet perdorur do te jete i nje ose disa tipeve qe vijone sic mund te specifikohet ne Specifikimin Special te urdheruar nga Inxhinieri.

- a) Gelqere Bujqesor
- b) Super Fosfate
- c) Gur Gelqeror Nitrat Amoni
- d) 2:3:2

8.6.1.2 Prerja Barit ose Rreshqitja

Prerja e barit ose Rreshqitja e nje tipi te aprovuar mund te nje shtrati te barit mund me materiale rrenje te mjaftueshem te siguroje nje rritje te mire.

8.6.1.3 Rrenja Barit

E vetmja rrenje e frekset me cilesi te mire do te perdoret dhe te gjitha tiper e rrenjeve ne nje perzierje rrenje do te specifikohet ne Specifikimin Special.

8.6.1.5 Shtresa Punueshme

Shtresa Punueshme do te konsistoje ne shkiftimin e tokes pjellore, te selektuar nga zonat e treguara duke treguar nje mbulesa te bimesise natyrale, ne menyre te preferueshme te barerave. Nuk do te kete probleme te demshme, te tilla si nje rruge e gjere, apo nga guret apo nga rrenjet helmuese, te cilat do te preknin vazhdimesine e tij per bimesine e mbjelle.

Aty ku eshte e specifikuar, Kontraktori do te prokuroje dhe furnizoje shtresen e punueshme nga burimet e tij jashte Terrenit, burim i tille do te aprovohet nga Inxhinieri.

Shtresa e Punueshme do te inventarizohet ne stiva te gjera te sheshuara nga kamionet dhe do te inventarizohet per lartesi me te larata se 2.0m. Kujdes do te tregohet per te parandaluar kompaktesine e shtreses se punueshme ne nje menyre, sidomos bga kamionet udhetues mbi materiale te tilla.

10.3 Pergatija e Zonave per Gjelberim

Zonat e ndryshme per tu mbjeel me bar do te pergatiten si vijon:

- (a) Zona qe nuk kerkojne Shtresa te Punueshme

Aty ku zonat qe do te mbillen me bar do te konsistojne ne nje material te pershtatshem organik, ato do do te shkriferohen ne nje minimum thellesie prej 150 mm. Te gjithë guret e gjere jo me te medhenj se 100 mm mbi zonat per t'u kositur nga makinat dhe qe bien Brenda rezervave te rruges dhe gjithë gureve me te medhenj se 150 mm ne zona te tjera do te levizen.

(b) Zonat qe Kerkojne Shtresa te Punueshme

Aty ku zonat qe do te mbillen me bar do te konsistojne ne nje material te papershtatshem organik, siperfaqja do te ashpersohet per te siguruar nje lidhje ndermjet shtreses se punueshme dhe nenshtreses se saj.

Shtresa e Punueshme do te vendoset ne siperfaqet e pergatitura dhe do te jete e prere ne menyre uniforme sipas trashesise se kerkuar. Shtresa e punueshme do te pergatitet nga mjetet e perzierjes se dheut dhe te gjithë guret do te levizin sic jane te specifikuar per zonat e kerkuara ne Nen klauzolen e mesiperme 33.3b.

(c) Pleherimi

Kontraktori do te kete majen 150 mm te siperfaqes se testuar per te gjetur tipin e pleheruesit te kerkuar per krijimin e kushteve te duhura per rritjen e barit. Pleheruesi do te aplikohet mbi gjithë siperfaqen ku bari bari eshte mbjelle dhe do te perzihet I teri deri ne nje thellesi prej 150 mm qofte ne menyre mekanike apo manuale.

10.4 Krijimi dhe Mirembajtja e Barit

Vaditja, Teharrja, P{rerja dhe Re-Mbjellja

Te gjitha zonat do te vaditen ne menyre te pershtatshme e te vazhdueshme per te siguruar rritjen e rrenjeve dhe te barit deri sa ky i fundit te kete krijuar nje mbulesa te pranueshme deri ne fillimin e periudhes se dekteve te barit. Masa dhe vazhdimesia e ujitjes do te jete subject i miratimit te Inxhinierit.

Kontraktori do te vijoje barin mbi te gjitha zonat ku eshte mbjelle bar sipas instruksioneve te Inxhinierit, deri sa te perfundoje periudha e defekteve. Gjithe prerja e barit do te mblidhet dhe do te jete ne disposicion nese eshte sipas direktivave te Inxhinierit. Cdo ane e zhveshur ku bari eshte demtuar apo thare, do te kultivohet, mbillet ose do te hidhet fare me shpenzimet e Kontraktorit.

Gjithe zonat me bar do te kene nje mbulesa te pranueshme sic pershkruhet me poshte si ne fillim dhe ne fund te peridhes se pergjegjesise se defekteve..

Mbulesa e Pranueshme

Nje mbulesa bari e pranueshme do te thote qe jo me pak se 75% e zones se mbjelle do te mbulohet me bar dhe qe ajo do te jete pa ane te zhveshura jo me shume se nje dimension maksimal ne 500 mm.

10.5 Kerkesat Suplementare

Koha e Mbjelljes

Mbjellja e barit, pemeve dhe shkurreve do te mbahet ne ato periudha per te prodhuar rezultate perfituese. Kontraktori do te beje cdo perpjekje per te programuar veprimet e tija ne nje menyre te tille qe ato te jene kryer ne menyre te tille.

Trafiku ne Zonat me Bar

Kontraktori nuk do mbjelle bar deri sa gjithë veprimet qe mund te kerkoje ndertimi I rruges apo dhe pasijet te jete dorezuar. Asnje pasije e ndertimit te rruges, kamione apo karoca vaditjeve do te lejohet ne zonat ku eshte bere mbjellja me bar dhe vetem paisjet e kerkuara per pergatitjen e zones, aplikimin e pleheruesit dhe shperndarjen e shtreses se pueshme do te lejohet te veprohet ne zonat e mbjella me bar.

Kontrolli Erozionit

Gjate ndertimit, Kontraktori do te mbroje gjithë zonat e me bar nga erozioni duke instaluar gjithë punimet e kullimit te nevosjshme si perkohesisht dhe permanent menjehere sapo te jene marre masa te tjera per te ndaluar perqendrimin e ujit siperfaqesor dhe ferkimin e bregut te pjerret dhe te zonave te tjera.

Cdo gije uji ose kanal erozioni qe zhvillohet gjate ndertimit te periudhes se defekteve do te mbushet dhe do te konsolidoje edhe zonat e rregulluara ne kushtet e tyre optimale. Kontraktori nuk do te lejoje erozionin te zhvillohet ne nje shkalle me te gjere para se riparimet dhe gjithë demet e erozionit do te riparohen sapo ne nje nje nga rast jo me vone se tre muaj para perfundimit te periudhes se defekteve. Gjithë shtresat e punueshme te materialeve te tjera te akumuluar ne kulluesit anesore do te levizen ne te njejten kohe. Shtresat e punueshme te lagura do te zevendesohen.

Pergjegjshmeria per Krijimin e nje Mbulese te Pranueshme

Pamvaresisht faktit qe Inxhinieri do te vendose metoden e gjelberimit me bar dhe tipin e rrenjes se barit si dhe masen e aplikimit te rrenjes mund te jete e specifikuar ose te jete rene dakort nga Inxhinieri qe vazhdueshmeria e kositjes do te urdherohet prej tij, kontraktori do te jete pergjegjes per krijimin e nje mbulese bari dhe per koston e rimbjelljes apo rihedhjen e fares aty ku mbulesa eshte e pranueshme. Megjithate, ku opinióni i Kontraktorit eshte ne dyshim nga i pari nese do te jete e mundur te krijohet nje mbulese e pranueshme, ai mund te informoje Inxhinierin per aresyet tij dhe Inxhinieri do te vendose, nese eshte dakort, nese do te adaptoje nje tjeter metode per mbjelljen e barit apo do te pranoje nje mbulese cfaredo duke perdorur gjithë metoden e propozuar. Cdo marreveshje e tille do te jete e vlefshme vetem nese do jete me shkrim nga ana e Inxhinierit.



10.6 Matjet dhe Pagesat

(i) Mbjellja me Bar

Mbjellja me Bar do te matet me meter katror per zonen e specifikuar. Shkalla e tenderuar do te perfshije gjithë kompesimin per furnizim, mbjellje dhe vaditje te barit. Ne cmim eshte perfshire dhe mirembajtja per 12 muaj e siperfaqeve te mbjella me bar.

(ii) Shtresa e Punueshme

Shtresa e Punueshme do te matet ne meter kub e do te matet si nje produkt I zones se specifikuar dhe trashesise se specifikuar.

Shkalla (norma) e tenderuar do te perfshije gjithë kompesimin per furnizimin e materialeve, kompaktesine, prerjen e barit, vaditjen per gjithë punet e nevojshme per te perfunduar punen dhe gjate periudhes se garancise se punimeve sipas Specifikimeve. Te gjitha shpenzimet te cilat duhen gjate garancise se punimeve kontraktori i ka te perfshira ne cmim.

10.7 DETAJE TEKNIKE

Periudha e zbatimit te projektit do te jete 12 muaj,

- Të gjithë llojet e bimësisë, drurët dhe shkurret që do të përdoren në gjelbërim, duhet të sillen pranë vendit ku do të implantohen (gropës) në vazo për siguri më të madhe në zënie. Vazo do te kete perimenter minimumi 50 cm dhe te shkurreve 30 cm.
- Lartësia e kurorës së drurit (trung i vetëkrasitur) nga sipërfaqja e tokës dhe nqs toka eshte e pjerrret, distanca nga niveli i rruges, pas implantimit të drurit, duhet të jetë minimumi 250 cm.
- Trungu deri në 250 cm duhet të jetë pa lastarizime, kurora e gjatë mund të jetë nga 150-250 cm.
- Lartësia totale e drurëve pas vendosjes në gropë (mbjelljes), duke parë edhe llojin e bimësisë, duhet të jetë nga 3.50 - 4 m nga niveli I tokes ose I rruges nese vendosen ne disnivel me rrugen.
- Trungu i vetëkrasitur i drurëve që do të përdoren në gjelbërim, duhet të jetë i pastër, pa plagë dhe me proçese të kallusimit natyral të perfunduara.
- Pemët duhet të shoqërohen me çertifikatë fitosanitare.
- Pemët do të mbështeten me anë të ristelave të drurit, të vendosura në mënyre trekëndore, sipas specifikimit.
- Gropat do të jenë të përmasave 80x80x80 cm për mbjelljen e pemëve.
- Madhësia e gropës për implantimin e shkurreve duhet të jetë 40 X 40 X 40 cm.
- Dheu me të cilin do të mbushen gropat, duhet të përmbaje pleh organik ne sasine 30 kg/grope per pemet dhe 15 kg/grope per shkurret.
- Pas mbjelljes se pemeve dhe shkurreve, kryhet mbjellja e barit me ane te teknologjise se Hidrombjelljes me trashesi te shtuar (me varietete barerash graminore te cilat respektojne varietet autoktone barishtore) dhe me stolone te copezuara.
- Te gjitha bimet (drure, shkurre dhe fara) duhet te shoqerohen me certifikaten e origjines dhe cilesise dhe pastertise varietore, si dhe duhet te certifikohen ne vend nga nje organ certifikues I akredituar I farave dhe fidaneve, **perpara se te kryhet mbjellja e tyre.**
- Per piketimin e vendeve te mbjelljes duhet angazhuar nje topograf.



- Te gjitha bimet qe do te mbillen duhet te jene tre jave perpara te magazinuara ne objektin mbeshtetes (fidanishte) per certifikimin e tyre dhe te njoftohet autoriteti kontraktor.
- Detaje teknike per kryerjen e punimeve te gjelberimit dhe gjate periudhes se garancise.**
- Perpara se te realizohet pergatitja e terrenit per mbjelljet e reja, duhet te kryhet pastrimi i skarpatave dhe siperfaqeve qe do te gjelberohen, nga mbetjet dhe inertet.
- Degezat e rena ne terren te pemeve si edhe shkurret e shkulura nga terrenet e percaktuara per t'u gjelberuar duhen prere me makineri korrese.
- Terrenet e gjelberuara duhet te korren te pakten 2 here ne muaj ne periudhen pranverevjeshte si edhe te pakten 1-2 here ne muaj ne periudhen vere dhe dimer.
- Gjethet e rena ne terren dhe anes rruges se pemeve duhen larguar.
- "Ne periudhen e thate Prill-Shtator nevojitet te kryhet ujitja 8 here ne muaj, 30 l per dru, per te pasur vegjetacion te bollshem, heret ne mengjes ose ne darke".
Bari nevojitet te ujitet cdo dite ne darke ose ne mengjes heret. "



11. SPECIFIKIME TE VECANTA

Projektim rikualifikim Urban I hyrjes se Qytetit te Shkodres dhe parkut per Pushuesit

FAZA 1 – Ndertimi i rrugekalimeve te reja

- **Ndertimi I rrugekalimeve te reja dhe shesheve :**

Rikonstruksioni do të konsistojë në këto pika:


- Ndertimi i shesheve dhe rrugicave.
- Shtrimi i shesheve dhe rrugicave
- Gjelbërimi
- Mobilimi
- Ndriçimi

- **Shtrimi I shesheve dhe rrugicave**

Shtrimi I sheshit do të bëhet me pllaka guri me këto specifikime:

- Mënyra e shtrimit është si në figurë:


Shtrim me pllaka beloni per sheshe




Shtrim me SETON ME PIGMENT RAL 8023



Shtirim me panel inox pasqyres tek themelet e ish objekteve le pazazit






Shtirim me pllaka guri gri e hapur RAL9018 30x60x5cm



Shtirim me pllaka betoni per trotuar RAL 9018 20x10x5cm



Shtirim me cakell NIDA GRAVEL





Në mungesë të të dhënave më specifike përzgjedhja e materialit bëhet nga arkitekti.

Në pjesët e specifikuara në projekt ku do të përdoren elementë të parapërgatitur betoni për kullimin e ujërave, do të përdoren element të tillë si në figurë:





Shtrim me pllaka betoni per trotuar
RAL 1014 20x10x5cm

Shtrimi i rrugices se mesit

Shtrimi I sheshit do të bëhet me pllaka guri me këto specifikime:

- Tulla betoni me përmasa 20x10x5 cm
- Mënyra e shtrimit është si në figurë:





- **Shtrimi i rrugicave dytesore**

Shtimi I rrugicave dytesore do te behet me material **nidagravel** si ne figure.

Ky material perbehet nga rrjete plastike rigjiduese si dhe nga mbushesi qe eshte cakell.



- **Bordurat kufizuese te rrugicave**

Bordurat kufizuese do të bëhen me pllakaguri me këtospecifikime:

- Pllakë guri gëlqeror I prerë dhe I trajtuar me bocardimpikësor $\pm 2\text{mm}$, me përmasa 11.1.1.1 **Gjeresi 10cm, gjatesi 50cm, lartesi 30cm.**







FAZA 2. Gjellbërimi


Gjellbërimi konsiston në shtrimin e sipërfaqeve të barit dhe në mbjelljen e pemëve. Sipërfaqjet e barit do të mbillen me tapet bari.

Pemët që do të mbillen janë:






NR.3 KUMBULL E KUQE




NR.4 PEME EZISTUESE (DISA LLOJE)



NR.7 LULESHUMENGYRESHE



NR.8 SHTRIM ME BAR




11.1.1.2 FAZA 3. Mobilimi urban

Mobilimi urban konsiston në përdorimin e tre lloje.

- Lloji 1 – stol ithjeshtë me ndriçim të fshehur poshtë. (Stolat tek sheshi fundor)

Stolat janë të parafabrikuar prej betoni të armuar të punuar për t'u lënë në dukje dhe me spesorë druri 4cm për t'u ulur. Në pjesën e poshtme është i pajisur me hapësirë për vendosjen e ndriçimit të fshehur.



- Lloji 2 – stolat për zonat e Pic-Nic.

Stolat në zonat e pic-nic përbëhen nga dy ulëse prej druri me permasa 30x30x150cm të ngritura 10 cm nga toka me ane të y kembzave metalike, si dhe nga një tavolinë e parapërgatitur beton-armeje me permasa 60x180cm dhe lartësi 75cm. Trashësia e betonit të jetë 8 cm tek tavolina. Të tre këto elemente vendosen mbi një bazament betoni të varfer me permasa 200x200cm. (si në figure)





- Lloji 3 – stolat ne rrugicat dytesore

Stolat ne rrugicat dytesore perbehen nga dy elemnte mbajtes te parapergatitur betonarme me permasa 50x50x15cm si dhe nga ulese horizontale druri me permasa 12x12x120cm.

(Si ne figure)



- d- Lloji 4 – stol I thjeshtë me ndriçim të fshehur poshtë. (Stolat tek rrugica kryesore)

Stolat janë të parafabrikuar prej betoni të armuar të punuar për t'u lënë në dukje dhe me spesorëdruri 4cm për t'u ulur. Në pjesën e poshtme është i pajisur me hapësirë për vendosjen e ndriçimit të fshehur.





FAZA 4.

a- Lodrat e fëmijëve do të jenë si në figurë. Duhet të jenë ekologjike, me kosto të ulëtdhe prej materiali sa më të lehtë.





b- Amfiteatri. Amfiteatri do te ndertoheh me beton a vista si ne figure.

Ngjyra e betonit te perzgjidhet nga projektuesi gjate zbatimit.








11.1.1.3 FAZA 5. Ndiçimi

Ndirçuesit që do të përdoren janë:

- Ndirçues shtyllë me lartësi 3m. per parkun
- Ndirçues shtyllë me lartësi 6m per rrugen hyrese

Ndirçuesi I parkut








Ndriçuesi I rruges:



Orao Small



Orao Medium



- Ndriçues t

ek shkallarja e amfiteatrit

Ndriçues për ambient os eorientues për ndriçimin e hapësirave publike.


Shkalla e mbrojtjes IP65.

Ndriçusei përbëhet nga alumin solid, vida çeliku inoks, plexiglass.





- Ndrëqes shirit LED



Shirit LED

Ngjyra - e Bardhe

Trupi - I pajisur me te gjitha aksesoret e nevojshem per funksionimin normal te shiritit LED

